



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## **KUVENDI I KOMUNËS PEJË**

**- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit.-**

**Numër:060/01-22438**

**Pejë, datë: 29. Mars 2024.**

### **PROCESVERBAL**

Nga takimi i II-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit të KK Pejë, i mbajtur me datë: 29. Mars 2024, me fillim në orën 12:00 h.

Takimi u mbajt në Zyren e kryesuesit të KK. Pejë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesja znj. Valbona Avdijaj.

Kryesuesja, fillimisht konstatoi se në takim prezentojnë të gjithë anëtarët e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit.

Pos anëtarëve të KKMM. Prezentojn: z.Avni Gashi, Sekretar i KK.Pejë, z.Gent Agolli, përfaqësues i Let's Do it Peja, dhe z.Lulzim Shala, përfaqësues i NPL."Ambienti" sh.a. Pejë.

Pas konstatimit të kuorumit për mbajtjen e takimit, kryesuesja znj. Valbone Avdijaja, hapi takimin e KKMM. dhe për këtë takim propozoi dhe nga të pranishmit njëzërit pa vërejtje, u miratu ky

### **REND DITE :**

- 1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshilëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.**
- 2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i I - rë i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mbajtur me datë 31.01.2024.**
- 3) Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027.**
- 4) Shqyrtimi i cilësisë së ajrit në Komunën e Pejes. – Let's Do it Peja.**

- 5) **Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Pejës, NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë.**
- 6) **Çështje të ngritur në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.**

## **I.**

### **Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesa.**

Në këtë takim prezentojn të gjithë anëtarët e KKMM-it.

## **II.**

### **Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i I-Rë i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, i mbajtur me datë: 31.01.2024.**

Procesverbali u miratua njëzërit pa vërejtje.

## **III.**

### **Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027.**

Në diskutim muarrën pjesë:

z. Ilir Thaci, informoi anëtarët se materiali në fjalë – plani, ka qenë për shqyrtim në kuvend, është miratuar por kur është proceduar për shqyrtim të ligjshmërisë ai është kthyer me vërejtje për përmirësim dhe harmonizim me dispozitat ligjore në fuqi. Plani ka të bëjë me periudhën 2023 – 2027, e tani jemi në vitin 2024. Andaj, kjo periudhë kohore është tejkalu dhe nga hartuesi i propozimit duhet harmonizuar plani me kohën e aplikimit të tij. Prandaj duhet ripunuar i njëjti. Në takim është prezent edhe z. Avni Gashi, sekretar i KK.- së që mund të informoi edhe me detajisht rreth propozimit në fjalë. Por, sidoqoft ky plan nuk është miratuar dhe është në procedurë të rishqyrtimit, ngase këtij plani duhet bashkangjitur edhe pasqyren financiare për të qenë komplet, i shqyrtueshem dhe i aprovueshem nga institucionet përkatëse.

Pas informimit nga z. Avni Gashi, lidhur me propozimin në fjalë, se materiali është në proces e sipër të rishqyrtimit dhe harmonizimit, u muar konkluzion që të pritët drafti i ri i planit që do të sjellet për shqyrtim dhe miratim dhe procedim të metejm, deri sa i njëjti të përgatitet plotësisht për implementim.

## **IV.**

### **Shqyrtimi i cilësisë së ajrit në Komunën e Pejës. – Let’s Do it Peja.**

z. Gent Agolli, përfaqësues i Let’s Do it Peja, informoi të pranishmit për cilësinë e ajrit në Komunën e Pejës, për matjet e bëra në disa zona duke potencuar disa zona ku cilësia e ajrit është mjaft e ndotur si psh. Si tek Qarshija e gjat, tek qebaptoret etj. Për paisjet e vendosura termike të

cilat ndikojn në cilësinë e ajrit etj. Ai njekohesisht foli edhe për masat që duhet ndërmarr në këtë drejtim, për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe për një ambient më të shëndosh.

## V.

### **Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Pejës, NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë.**

z.Lulzim Shala, përfaqësues i NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë informoi të pranishmit lidhur me menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Pejës, duke theksuar se situata në këtë drejtim është mjaftë e volitshme bazuar në kushtet dhe rrethanat në të cilat punohet. Cilësia është në nivel dhe më e kënaqshme se vitet paraprake dhe se komuna e Pejës, prin në këtë drejtim në krahasim me komunat tjera. Por, sidoqoft gjithnjë ka mundësi për përmirësim dhe avansim si në punë ashtu edhe në përmirësim të kushteve të punës me blerjen dhe anagazhimin e paisjeve të nevojshme teknike etj.

Në diskutim muarrën pjesë: kryesuesja znj. Valbona Avdijaj, dhe znj. Valdrine Gashi, Sauda Pantinaj dhe Atdhe Krasniqi, duke potencuar çështjen e përmirësimit të kushteve për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Pejës, vendosjen në pjesë të ndryshme të kontejnerëve adekuat për grumbullim të mbeturinave dhe duke bërë seleksionimin e tyre. Si dhe njekohesisht potencuan nevojën e kujdesit dhe shërbimit për largimin e mbeturinave inerte duke përcaktuar kohën dhe afatin kur ato duhet grumbulluar, me qëllim të informimit të banorëve se ato po grumbullohen në disa hapsira publike pa një rregull të përcaktuar dhe kështu po ndotin ambientin.

## VI.

### **Çështje të ngritur në mbledhje nga udheheqësi apo anëtarët.**

Anëtarët KKMM.-sit znj. Valdrine Gashi dhe znj. Sauda Pantinaj dhe kryesuesja Valbona Avdijaj, sugjeruan që për shqyrtim në rend dite për seancën e radhës të jetë:

- Shqyrtimi i cilësisë së ujit në Komunën e Pejës, gje që u përkrah edhe nga anëtarët tjer të KKMM.-sit.

Mëqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës, e propozime tjera nuk pat, kryesuesja e takimit znj. Valbona Avdijaj, e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 14,20 h.

**Pejë, dt. 29. Mars 2024**

**Procesmbajtësi,  
Sauda Pantina**

**Kryesuesja e KKMA.  
Valbona Avdijaj**

